

Në datë 23 shkurt 2024 u mbajt në Tiranë, Takimi kombëtar në kuadër të projektit Rritja e cilësisë së arsimit dhe trajnimit në EJT – EQET SEE dhe u mbështet nga Agjencia Austriake për Zhvillim me fondet e Bashkëpunimit Austriak për Zhvillim. Në këtë takim u prezantua Pyetëtori i nevojave për trajnim të vlerësuesve të jashtëm në shtatë vendet e EQET SEE: Shqipëri, Bosnja dhe Hercegovina, Kosova\*, Moldavi, Mali i Zi, Republika e Maqedonisë së Veriut dhe Serbi. Qëllimi i takimit kombëtar ishte të zhvilloheshin diskutimet në grupin e ekspertëve, duke çuar përfundimisht në përafrimin e suksesshëm të pyetësorit të analizës së nevojave për trajnim rajonal me kontekstin kombëtar.

Pjesëmarrës në këtë takim ishin:

- ◆ Ejvis Gishti– Drejtor i Përgjithshëm AKAFPK
- ◆ Teuta Çobaj – NCP
- ◆ Etleva Kaçuli – NCP
- ◆ Flutura Vaqarri – Ekspert (Vlerësues të jashtëm të AFP-së)
- ◆ Alketa Sulo– Ekspert (Vlerësues të jashtëm të AFP-së)
- ◆ Gentiana Baholli– Ekspert (Vlerësues të jashtëm të AFP-së)
- ◆ Sara Hoxhallari– Ekspert AKAFPK
- ◆ Ana Semini– Ekspert AKAFPK



Drejtori i Përgjithshëm Ejvis Gishti theksoi rëndësinë e ERI SEE në procesin e sigurimit të cilësisë në arsim dhe formimin profesional.

Më tej u diskutua përdorimi i pyetësorit për të identifikuar nevojat për trajnim të vazhdueshëm të vlerësuesve të jashtëm të procesit të akreditimit të AFP-së në nivel kombëtar.

U theksua se sigurimi i qëndrueshmërisë dhe koherencës në qasjet e trajnimit nëpër rajone të ndryshme është thelbësor. Përafrimi i këtyre qasjeve me qëllimet dhe objektivat gjithëpërfshirëse kombëtare lehtëson sinergjinë dhe maksimizon ndikimin e përpjekjeve të trajnimit.



Vlerësuesit e jashtëm, të cilët ishin gjithashtu pjesë e grupit të parë, në të cilin u aplikua pyetëtori rajonal për vlerësimin e nevojave për trajnim, theksuan se pyetëtori është i realizuar mirë, i kuptueshëm dhe miqësor për përdoruesit.